



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0069482-3/24 dt. 30.10.2024
Mitrovicë



Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, nënparagrafi d, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/15, qershor 2008); nenet: 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe 73, të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4 dt. 24.09.2020; nenin 9, të Rregullores Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2024, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0067951-3/24 dt. 23.10.2024); miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit të Ankesave për ndarjen e bursave

1. Formohet Komisioni i Ankesave për ndarjen e bursave, në përbërje:
 - 1.1 Armend Begu
 - 1.2 Muhamed Hoti
 - 1.3 Drita Ibrahim
 - 1.4 Ferdi Kadriu (nga Ekzekutivi),
 - 1.5 Valbone Sadiku (nga shoqëria civile).
2. Komisioni ka për detyrë të shqyrtojë ankesat lidhur me konkursin për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2024/2025, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me konkurs dhe në harmoni me Rregulloren Komunale Nr. 02/2020 Për ndarjen e bursave për studentë.
3. Komisioni ka tridhjetë (30) ditë kohë nga dita e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave, të marr vendim lidhur me ankesat dhe vendimet lidhur me ankesën t'ua dorëzoj me shkrim secilit parashtrues të ankesës.
4. Vendimi i Komisionit të ankesave është përfundimtar në procedurë administrative.
5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës, Kryesuesja e Kuvendit dhe Komisioni i formuar me këtë vendim.
6. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit
1 x 1 MAPL
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të emëruar



Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA